



SUMMER CAMP

PËRMBLEDHJE PROGRAMIT 10 DITOR



SUMMER CAMP

SUMMER
2023

Përmbledhje
Programit 10 ditor

DITA 1

MIRËSE VINI!

Programi i kësaj dite përfshin grumbullimin dhe nisjen në kamp, akomodimin në mjediset e kampit dhe drekën. Pas drekës, fëmijët bëjnë një shëtitje në mjedisin e kampit për ta njohur atë, por edhe njëri-tjetrin. Kjo ditë do të fokusohet në aktivitetet për ndërtimin e grupit të cilat janë shumë të rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit dhe ndërtimin e një dinamike pozitive midis pjesëmarrësve të kampit.

Këto aktivitete do të përfshijnë lojëra, sfida, diskutime, etj., që ndihmojnë anëtarët e grupit të lidhen me njëri-tjetrin dhe të mësojnë të bashkëpunojnë për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve është të rrisin aftësitë e fëmijëve për të komunikuar më mirë, të ndajnë sa më qartë idetë e tyre dhe të ndërtojnë besim tek njëri-tjetri. Gjithashtu aktivitetet fillestare janë hartuar në mënyrë që të nxisin mendimin kritik dhe aftësitë organizative duke ndihmuar në njohjen e detyrave dhe rolit të secilit anëtar të grupit.

Përgjatë programit do të ketë pushime me një ushqim të lehtë (snack) dhe lojëra në grup. Në një moment të caktuar, do të reflektojmë për ecurinë e ditës dhe ndodhitë e ndryshme me një checkpoint të shkurtër, pastaj do të kemi darkë dhe festë surprizë, të përbashkëta.

DITA 2

TË DREJTAT E MIA!

Programi i ditës së dytë është i dedikuar për të mësuar më shumë rreth të drejtave të fëmijëve dhe si funksionon demokracia. Pas mënjeshtër, fëmijët do të grupohen për të marrë pjesë në një aktivitet kreativ, ku ata do të krijojnë një poster me temën "Kush jam unë!"

Më pas, me anë të metodave kreative dhe ndërvepruese, do të mësojmë më shumë rreth të drejtave të fëmijëve dhe do të bëjmë një pemë të të drejtave të tyre.

Është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë rreth të drejtave të njeriut, sepse kjo i ndihmon ata të kuptojnë jo vetëm të drejtat, por edhe detyrimet, duke u bërë qytetarë aktivë dhe me integritet. Duke mësuar më shumë rreth tyre, ata do të zhvillojnë një ndërgjegjësim më të thellë për nevojën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe rolin që duhet të luajnë në shoqëri, në jetën personale dhe sociale. Mësimi i të drejtave të njeriut ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësi si empatia, respekti dhe toleranca ndaj të tjerëve. Ata mësojnë si t'i trajtojnë të tjerët me dinjitet dhe si të ndihmojnë në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe si të forcojnë familjen dhe demokracinë. Mësimi i këtyre të drejtave ndihmon në përmirësimin e komunikimit dhe aftësive sociale, dhe ndikon në formimin e një personi të qytetëruar dhe të ndërgjegjshëm për shoqërinë dhe botën në tërësi.

Çdo ditë fëmijët do t'i dedikojnë një kohë të veçantë për të dhënë ide dhe për të dizajnuar performancën finale në mbyllje të kampit, ku do të jenë të ftuar dhe familjet e fëmijëve.

Gjatë pasdites do të ketë aktivitete animacioni dhe argëtuese, ndërsa në mbrëmje do të ketë aktivitete të përbashkëta me muzikë.

DITA 3

NE JEMI TË BARABARTË!

Dita e tretë e programit i është e dedikuar konceptit të solidaritetit, empatisë dhe përfshirjes sociale. Krijimi i empatisë, inkurajimi i solidaritetit dhe përfshirjes sociale, janë qëllime të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të një shoqërie dhe prandaj është e nevojshme që këto koncepte të kultivohen te fëmijët që në moshe të hershme. Aktivitetet e planifikuara kanë për qëllim të sensibilizojnë dhe të edukojnë fëmijët rreth këtyre temave përmes ushtrimeve të ndryshme ndërvepruese. Ushtrimi "Limiti 20!" është për të kuptuar se si disa grupe në shoqëri janë më të marginalizuara dhe për të krijuar empati. Shëtitja me sy mbyllur dhe futbollit me syze, rrisin ndërgjegjësimin për nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara në shoqërinë tonë.

Pasditë fëmijët do të angazhohen në projektin kreativ të bërjes së maskave, të cilat më vonë do t'i pikturojnë. Si çdo ditë, nuk do të mungojnë lojrat dhe aktivitete fizike për fëmijët, të cilat nxisin bashkëpunimin, krijimtarinë, si dhe ndikojnë në përmirësimin e shëndetit mendor dhe fizik të fëmijëve. Në mbrëmje do të organizojmë karaoke dhe aktivitete të tjera argëtuese sipas interesave të fëmijëve.

DITA 4

UNË MARR PJESË!

Dita e katërt e programit i kushtohet qytetarërisë aktive, pjesëmarrjes dhe luftës kundër bullizmit. Përmes aktiviteteve të bazuar në ushtrime stimuluese, fëmijët do të mësojnë rreth rëndësisë së pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe marrjes së iniciativës për të ndryshuar gjërat për mirë. Lehtësuesit do të drejtojnë sesionet përkatëse, të strukturuar në mënyrë të tillë që të përshtaten me moshën e fëmijëve mbi temat e qytetarisë aktive dhe bullizmit.

Fëmijët do të kenë mundësi të shprehin mendimet e tyre dhe të dizenojnë ide konkrete për të luftuar bullizmin dhe gjuhën e urrejtjes në mënyra kreative dhe efektive (në shkollë dhe në komunitet).

Gjatë ditës, fëmijët do të bëjnë përgatitjet e duhura dhe punë në grup për të përgatitur performancën finale në përfundim të kampit. Gjithashtu, fëmijët do të vënë në praktikë kreativitetin dhe ndërveprimin pozitiv duke u përfshirë në aktivitetin shumëgjyresh "Dita e ngjyrave - Colour Day". Përveç aktiviteteve argëtuese me lojra dhe muzikë, ky është një moment për të ndërgjegjësuar fëmijët rreth ndryshimit dhe diversitetit në një mënyrë të argëtueshme dhe edukative.

Në mbrëmje, fëmijët do të kenë mundësi të shohin një film dhe ta diskutojnë së bashku.

DITA 5

AFTËSI, DËSHIRA DHE PASIONE!

Paraditja do të dedikohet dëshirës për të ndarë njohuritë mbi aftësitë e buta dhe sipërmarrjen, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve, për të nxitur mendësinë e krijimit të biznesit dhe sipërmarrjes. Duke u angazhuar në aktivitetet e planifikuara, fëmijët do të mësojnë si të ndërtojnë në disa hapa një biznes, si të jenë kreativë dhe inovativë, si të marrin vendime të rëndësishme dhe si të bashkëpunojnë me të tjerët për të arritur një qëllim të përbashkët. Aktivitetet e planifikuara do të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive për komunikim, menaxhimin e kohës, kreativitetin dhe në përgatitjen e fëmijëve për të bërë pjesë në një projekt ideje biznesi.

Njohuria për biznesin/sipërmarrjen mund të ndihmojë fëmijët të kenë një qëndrim pozitiv ndaj sfidave dhe të mos kenë frikë nga dështimet. Ata mësojnë si të identifikojnë një problem dhe të gjejnë zgjidhjet e duhura. Nëse ata kanë ndonjë ide të re, ata mund ta zhvillojnë dhe ta ndajnë me të tjerët, duke krijuar një kulturë të kreativitetit dhe inovacionit.

Kjo mund të ndihmojë fëmijët të jenë të pavarur dhe të përgatiten për të ardhmen e tyre, duke ndërtuar tregun e tyre dhe duke kontribuar në zhvillimin e një shoqërie më të mirë.

Pasdite, fëmijët do të punojnë në grupet e tyre për performancën finale të planifikuar. Pjesa tjetër e pasdites do t'i dedikohet takimit me prindërit dhe implementimit të aktiviteteve të përbashkëta kreative dhe sportive. Dita do të mbyllet me aktivitetin e mbrëmjes, i cili është tregime rreth zjarrit dhe pantomimëve.

DITA 6

GJUEIA E THESARIT!

Kjo ditë planifikon të përdorë edukimin në natyrë për fëmijët përmes aktivitetit "Gjuetia e Thesarit". Eventu është planifikuar të jetë interaktiv dhe qëllimi i tij është që fëmijët jo vetëm të argëtohen me aktivitete në natyrë, por edhe të mësojnë dhe të zhvillojnë disa aftësi si bashkëpunimi, orientimi dhe kreativiteti.

Në këtë aktivitet, fëmijët janë të ndarë në grupe dhe udhëzohen të gjejnë objekte të ndryshme në një zonë të caktuar në kohë të caktuar. Kjo do të kërkojë nga ata të bashkëpunojnë, të marrin vendime, të zhvillojnë strategji dhe të orientohen në mjediset e kampit dhe rrethinat.

"Gjuetia e Thesarit" nxit anëtarët e secilit grup të bashkëpunojnë dhe të ndërveprojnë së bashku për të arritur objektivin e kërkimit të thesareve. Në këtë mënyrë, fëmijët do të mësojnë si të ndajnë detyrat dhe të punojnë së bashku për të arritur një qëllim të përbashkët, të dëgjojnë njëri-tjetrin, të jenë të vëmendshëm për detajet etj. Aktiviteti do të ndihmojë fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre sociale dhe emocionale, siç janë bashkëpunimi, komunikimi, orientimi në natyrë, pavarësia, besimi dhe respekti. Gjithashtu, disa aktivitete si ndërtimi i foleve të zogjve, pikturimi i maskave, lojërat sportive tradicionale do t'u mundësojnë fëmijëve ndërveprim dhe do t'i nxisin ndjenjat e vlerësimit dhe përgjegjësisë ndaj botës natyrore dhe mjedisit.

Pasdite do të vazhdojnë përgatitjet përkatëse për performancën finale dhe në mbrëmje fëmijët do të mësojnë të kërcejnë valle nga vende të ndryshme të botës.

DITA 7

KRIJO DUKE RICIKLUAR!

Kjo ditë i dedikohet kreativitetit të fëmijëve duke i nxitur këto aftësi tek secili prej tyre.

Aktivitetet e planifikuara janë strukturuar me qëllim që secili fëmijë të marrë pjesë dhe të ketë një rol në proces duke filluar nga mbledhja e ideve, mënyra si do të punojë çdo grup, produktet e krijuara dhe prezantimi kreativ i tyre në formën e sfilatës. Gjithashtu, aktiviteti promovon ndërveprimin dhe edukimin e fëmijëve për rëndësinë e riciklimit dhe ndikimin e saj në mbrojtjen e mjedisit. Përmes krijimit të veshjeve me materiale të ricikluara, fëmijët do të mësojnë të krijojnë artikuj të rinj dhe origjinalë duke rikthyer materialet e përdorura në qarkullim.

Aktiviteti do të forcojë gjithashtu aftësinë e fëmijëve për të punuar në grup dhe të bashkëpunojnë në krijimin e diçkaje të përbashkët, ndërkohë që kanë mësuar më shumë për rëndësinë e punës së bashku në ditët e mëparshme. Sfilata e veshjeve të ricikluara do të shërbejë si një mënyrë për të përqaftuar kreativitetin dhe punën e palodhur të fëmijëve, duke e bërë këtë aktivitet më të argëtueshëm dhe më interesant për ta.

Puna e fëmijëve do të finalizohet në sfilatën e planifikuar pasdite vonë, ku ata do të mund të shijojnë frytet e punës së tyre në grup.

Në mbrëmje është planifikuar të shfaqet një film i përshtatur për moshën e fëmijëve.

DITA 8

RRITEMI TË SHËNDETSHËM!

Shëndeti është një nga temat më të rëndësishme, prandaj në program i kemi kushtuar një rëndësi të veçantë shëndetit dhe sigurisë së fëmijëve. Nëpërmjet aktiviteteve të planifikuara nga DPSHTRR, Skoda & Kryqi i Kuq Shqiptar & Policia Bashkiake fëmijët do të marrin njohuri për rregullat e qarkullimit rrugor dhe ato të policisë në komunitet. Fëmijët do të mësojnë rregullat e qarkullimit rrugor, duke fituar njohuri mbi mënyrën e sigurt të ecjes në rrugë, si dhe mbi kuptimin dhe rëndësinë e sinjalizimit dhe treguesve të qarkullimit.

Njohja e rregullave të policisë në komunitet i ndihmon ata të kenë një ide të qartë mbi mënyrën se si funksionon siguria në shoqëri dhe si të jenë pjesë aktive në komunitetin e tyre. Në mënyrë të përgjithshme, njohja e rregullave të qarkullimit rrugor dhe rregullave të policisë në komunitet ndihmon fëmijët të kenë një sjellje më të rregullt dhe të shmangin rreziqet në rrugë dhe në jetën e përditshme. Në të njëjtën kohë, kjo mund të ndihmojë në rritjen e vetëbesimit dhe aftësive sociale të fëmijëve, duke u bërë pjesë e një komuniteti më të sigurt dhe më të përgjegjshëm.

Gjithashtu, në një nga workshop-et është planifikuar të kemi eksperte të ushqimit të shëndetshëm, mjek, sportist etj. Të ftuarit do të ndajnë me fëmijët njohuritë e nevojshme, por gjithashtu fëmijët do të kenë mundësi të bëjnë pyetje të cilat lidhen me temën e shëndetit.

Gjatë pasdites janë planifikuar lojëra argëtuese dhe animacion. Mbrëmja do të mbyllet me aktivitetin "Ëndrrat e mia", i cili është konceptuar në formën e meditimit dhe reflektimit dhe një mënyrë për t'i afruar me shumë shoqëritë e krijuara në kamp përgjatë 8 ditëve më parë që zgjasin përgjithmonë, një nga aktivitetet me impaktin më të madh emocional.

DITA 9

TALENTI JEMI NE!

Kjo ditë është shumë e rëndësishme, pasi finalizon të gjitha përpjekjet e fëmijëve në një performancë të përbashkët, të përgatitur me shumë kujdes gjatë gjithë ditëve të kampit prej kampistëve, nga kampistët për prindërit.

Një sesion i veçantë do t'i kushtohet reflektimit dhe procesit të mesimit në kamp, për të marrë feedback dhe vlerësimet e fëmijëve për kampin, por edhe sugjerime për ta bërë atë edhe më të bukur për herën tjetër. Gjithashtu, fëmijët do të kenë kohën e mjaftueshme për të bërë provat e përgjithshme të performancës dhe në darkë vonë ta shfaqin atë para prindërve dhe familjarëve të ftuar.

DITA 10

SHIHEMI HERËN TJETËR!

Fëmijët do të përgatiten për t'u kthyer në shtëpi dhe do të marrin kohën e duhur për t'u përshëndetur me shokët dhe shoqet, pjesëmarrësit dhe stafin e kampit duke shënjuar dhe kujtimet e fundit të një eksperience unike dhe magjike.